VENDIM
Nr.852, datë 13.12.2006

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KORÇË-KAPSHTICË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë-Kapshticë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 7 596 m^2, tokë bujqësore, e vlerësuar me 1 000 lekë/ m^2, në shumën 7 596 000 (shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për sipërfaqen 7 380 m^2, tokë truall, e vlerësuar me 4 000 lekë/ m^2, në shumën 29 520 000 (njëzet e nëntë milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë, për sipërfaqen 1 452 m^2, tokë bujqësore, e vlerësuar me 600 lekë/ m^2, në shumën 871 200 (tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme 37 987 200 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 37 987 200 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri "Shpronësime", nga investimet në sektorin rrugor, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
5. Shpenzimet procedurale, në shumën 185 500 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit dhjetor 2006.
7. Likuidimi i pronarëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëhet brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONAREVE QE DO TE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KORCE-KAPSHTICE.

BY PASS KORCE

Për tokën Bujqësore

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Sip. m2	Cmimi	Vlera
1	Mihallaq Boco	8561	13/1	200	1000	200000
2	Petraq Pojani	8561	9/23	224	1000	224000
3	Dhori Pojani	8561	9/22	266	1000	266000
4	Pandi Foto	8561	9/24	280	1000	280000
5	Jorgaq Gulimaci	8561	9/21	280	1000	280000
6	Fiqret Kamenica	8561	9/18	280	1000	280000
7	Sulejman Voskopi	8561	9/20	280	1000	280000
8	Rexhep Furamani	8561	9/19	280	1000	280000
9	Llazi Jano	8561	9/17	285	1000	285000
10	Krisanthi Tole	8561	9/16	219	1000	219000
11	Sabrie Kosturri	8561	9/15	468	1000	468000
12	Agim Morava	8561	9/14	288	1000	288000
13	Reshat Troka	8561	9/13	810	1000	810000
14	Raif Ushini	8561	9/12	558	1000	558000
15	Edmond Shore	8561	9/11	504	1000	504000
16	Resmije Bixhaku	8561	9/10	288	1000	288000
17	Fatos Terolli	8561	9/9	270	1000	270000
18	Edmond Pojani	8561	9/8	288	1000	288000
19	Haxhi Gura	8561	9/7	558	1000	558000
20	Kadri Gjanci	8561	9/6	270	1000	270000
21	Xhemil Goskova	8561	Plotësim dokumentacioni	30	1000	30000
22	Haxhi Goskova	8561	Proces Rregjistrimi	130	1000	130000
23	Rahman Goskova	8561	Proces Rregjistrimi	540	1000	540000
						7.596.000

Për tokën truall

1	Xhemile Metko	8561	10/30	175	4000	700000
2	Festim Qelemeni	8561	10/27	780	4000	3120000
3	Bashkëpronarët Viktori Abazi Rajmonda Meleq Guri Vjollca Meleq Shahini	8561	10/31	800	4000	3200000
4	Guri Cico	8561	10/26	400	4000	1600000
5	Kostandin Kicollari	8561	8/97	330	4000	1320000

6	Pali Kicollari	8561	8/96	420	4000	1680000
7	Shpresa Mujo	8561	8/118	102	4000	408000
8	Adrian Azizi	8561	8/101	560	4000	2240000
9	Adrian Azizi	8561	8/117	93	4000	372000
10	Bashkim Azizi	8561	8/102	374	4000	1496000
11	Ibrahim Fidani	8561	8/110	260	4000	1040000
12	Krisanthi Vangjeli	8561	8/103	264	4000	1056000
13	Erieta Vangjeli	8561	8/103	264	4000	1056000
14	Marika Mihal	8561	8/109	360	4000	1440000
15	Bashkepronaret Ollga Riza Ilia Riza Zhaneta Riza Vladimir Riza Gjengji Riza Spiro Riza Petraq Riza Vangjel Riza Marjeta Riza Jera Riza Kristaq Riza	8561	8/203	1820	4000	7 280 000
16	Jetnor Pulaha	8561	8/180	378	4000	1512000
						29.520.000

Useku Kapshtice

Për tokën bujqësore

Nr	Emër Mbiemër	Nr. Pasurisë	Sip. m2	Cmimi	Vlera
1	Zija Muco	147/1	300	600	180000
2	Demirali Xhaferri	147/2	522	600	313200
3	Veiz Yzeiri	147/3	630	600	378000
					871.200

Vlera totale e shpronësimit është 37.987.200 (tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind), lekë.